

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Kujtime Koçinaj, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit F.G, nga ..., për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 1800/2010 të datës 10.01.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Zejnel Kodra, dhe të akuzuarit, me date 27.10.2014 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.G, nga i ati M.. dhe nëna A., me mbiemër të vajzërisë ..., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna e ..., tani jeton në ..., rruga “...” nr, ..., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pamartuar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, Shtetar i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se në mes të datave 24.05.2010 – 26.05.2010, në orë të papërcaktuar, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër – këtu të dëmtuarit H.B, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e përshtatshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, pasi që i njëjti gjendet në punë të përkohshme në Zvicër, me përdorimin e forcës apo edhe mjetit të përshtatshëm për hapjen e hapësirave të mbyllura, thyen derën hyrëse të shtëpisë të dëmtuarit, e cila gjendet në rrugën “...”, në ..., në shoqëri edhe me të miturin A.D, prej nga futen brenda në shtëpi dhe aty marrin një televizor Pllazma të markës “ACER”, një studio të markës “QONIX”, dhe një radio, dhe pastaj largohen nga vendi i ngjarjes, pa u vërejtur nga askush, i pandehuri F.G, televizionin plazma të markës “ACER” ja shet personit Sh.H, nga ..., ndërsa studion e markës “QONIX”, konfiskohet nga ana e pjesëtarëve të policisë në shtëpinë e të pandehurit F.G,

Këso dore ka kryer veprën penale të vjedhjes të rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, të akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 4 (katër) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale.

I dëmtuari H.B, nga ..., rruga "...", pa numër, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësore në shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 1800/2010 të datës 10.01.2012, kundër të akuzuarit F.G, nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 par.1 nën par. 1 e lidhur me nenin 23 te KPK-ës,

Prokurori i shtetit Zejnel Kodra, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: qëndroj pranë aktakuzës PP.nr.1800/2010 e datë 10.01.2012 , kundër të akuzuarit F.G, nga ..., për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KPP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë

I akuzuari F.G, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: më vije keq për veprën e shkaktuar, e tëra kjo që ka ndodhur dhe koha kur ka ndodhur, unë kam qenë i moshës relativisht të re diku rreth 20 vjeçar, pendohem thellë për veprën e kryer, dhe të gjitha sendet që janë marrë nga ana ime në bashkëpunim me të miturin në atë kohë A.D, janë kthyer të dëmtuarit, mu ashtu edhe si ceket edhe në aktakuzë. Televizorin që e kam shitur personit Sh.H, po ashtu është marrë nga ana e pjesëtarëve të policisë, dhe e njëjta i është kthyer të dëmtuarit. Unë nuk e kam njohur fare të dëmtuarin H.B, vetëm e kam ditur që shtëpia e cekur e tij është e pabanuar, dhe se i njëjti është në punë të përkohshme në Zvicër. Andaj i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, si dhe pendimin tim të thellë ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se në mes të datave 24.05.2010 – 26.05.2010, në orë të papërcaktuar, i akuzuari, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër – këtu të dëmtuarit H.B, në atë mënyrë që shfrytëzon momentin e përshtatshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, pasi që i njëjti gjendet në punë të përkohshme në Zvicer, me përdorimin e forcës apo edhe mjetit të përshtatshëm për hapjen e hapësirave të mbyllura, thyen derën hyrëse të shtëpisë të dëmtuarit, e cila gjendet në rrugën “...”, në .., në shoqëri edhe me të miturin A.D, prej nga futen brenda në shtëpi dhe aty marrin një televizor Pllazma të markës “ACER”, një studio të markës “QONIX”, dhe një radio, dhe pastaj largohen nga vendi i ngjarjes, pa u vërejtur nga askush, i pandehuri F.G, televizionin plazma të markës “ACER” ja shet personit Sh.H, nga Prizreni, ndërsa studion e markës “QONIX”, konfiskohet nga ana e pjesëtarëve të policisë në shtëpinë e të pandehurit F.G,

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes të rëndë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, ku ka qenë i moshës rreth 20 vjeçare, sjellja e tij pas konfliktit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 4 (katër) viteve, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
PKA.nr.4/2012 me datë 27.10.2014

Procesmbajtësja
Kujtime Koçinaj

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.